

Maqedonia: Mikrokreditimi, varfëria dhe kthimi i pakicave etnike

nga Albert Musliu dhe Visar Ademi



Pamje nga rrugët e Maqedonisë Foto: ADI

Hyrje

Republika e Maqedonisë ka një popullatë gati mbi 2 milionëshe, me sipërfaqe tokësore prej 26,000 km², në zemër të Ballkanit, e kufizuar me Shqipërinë, Bullgarinë, Serbinë dhe Malin e Zi, Greqinë dhe Kosovën.

Më 1991 Maqedonia fitoi pavaresinë nga Jugosllavia dhe në ekzistencën e saj të shkurtë Maqedonia është rrethuar me tensione etnike, jostabilitet politik dhe konflikte. Fillimisht u shfaq një konflikt i madh politik me Greqinë rreth emrit të shtetit (me një zgjedhje të pakënaqshme të emrit – Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë – FYROM). Tensionet e brendshme u rritën me adoptimin e politikave nacionaliste nga ana e Qeverisë duke e favorizuar shumicën etnike të komunitetit maqedonas. Këto tensione u rritën me luftën e Kosovës më 1999 dhe vërshimin e madh të refugjatëve. Konflikti i armatosur ndërretnik më 2001 mes shqiptarëve dhe maqedonasve njihet mirë, megjithatë, kriza ekonomike është pak e njohur jashta regjionit.

Ky studim nxjerr në pah çështjet të cilat i kanë detyruar punëtorët migrues që kanë dashur të kthehen në Maqedoni, ndërsa në fakt të mbeten në Gjermani. Kjo ndodhi pavarësisht nga programet mikro – kreditore të financuara në qeveria gjermane. Shumica e migrantëve i takojnë komuniteteve etnike minoritare.

Përberja etnike e Maqedonisë

Maqedonia është etnikisht e shumëllojshme dhe sipas regjistrimit të vitit 1994, popullata e saj përbëhet nga: 66.5 % maqedonas, 22.9 % shqiptarë, 4.0 % turq, 2.0 % rom, dhe 4.6 % serb, vllleh dhe të tjerë. Shumica e komuniteteve etnike jomaqedonase shprehin dyshim në këto të dhëna. Regjistrimi i

organizuar nga dy partitë politike shqiptare më 1993, tregoi se shqiptarët në Maqedoni përbejnë 35 përqind, përderisa përfaqësuesit politik të komunitetit turk dhe rom deklarojnë se komunitetet e tyre përbejnë 8 deri 10 përqind të popullatës së përgjithshme.

Shumica e shqiptarëve jetojnë në Maqedoninë Perëndimore (përfshirë këtu Dibërën, Gostivarin, Kërçovën, Resnjën, Strugën dhe Tetovën) ku ata janë shumicë numerike, dhe mbi rreth 20 përqind e popullatës së kryeqytetit, Shkupit, janë shqiptarë. Në Maqedoninë Lindore, ka pak shqiptarë, por ka numër të konsiderueshëm të turqve dhe romëve.

Më parë, shqiptarët vuajtën diskriminim të gjërësishëm në Jugosllavi, dhe kjo vazhdoi me themelimin e shtetit të pavarur maqedonas. Gjuha dhe kultura shqiptare vazhduan të marginalizohen ndërsa diskriminimi vazhdoi në arsimim, punësim ndërsa pjesëmarrjet e tyre ishin të kufizuara. Pjesa më e madhe e nacionalizmit maqedonas dhe politikat e tyre diskriminuese ishin të drejtuara kundër shqiptarëve, që nga ana e maqedonasve shihej si kërcnim. Romët, turqit dhe komunitetet më të vogla monoritare poashtu ishin objekt diskriminimi.

Shumica e shqiptarëve migruan në Gjermani dhe Evropën Perëndimore në kërkim të punës. Ata kanë shpresuar të kthehen në familjet e tyre por diskurajoheshin nga nacionalizmi maqedonas dhe mungesa e punës për shqiptarët. Maqedonia ka qenë në kriza ekonomike që nga pavarësia më vitin 1991. Këto kanë inicuar jostabilitet dhe tensione ndërretnike. Pas pavarësisë Maqedonia ishte e etshme për t'u pranuar nga komuniteti ndërkombëtar dhe të tërheq investime

ndërkombëtare. Si rrjedhim, Maqedonia e vazhdoi politikën e përshtatjeve strukturale që në atë kohë favorizohej nga Fondi Ndërkombëtar Monetar (IMF), Banka Botërore dhe shumë donatorë ndërkombëtar. Këto politika çuan në privatizimin e industrive të nacionalizuara si hyrje në paraqitjen e ekonomisë së tregut. Situata tashmë ishte akute pasi që Maqedonia i kishte humbur tregjet e saja në Jugosllavi, dhe fqinjët kishin probleme të rënda ekonomike gjatë konflikteve në regjion. Këto konflikte poashtu diskurajuan investimet.

Në vitin 1998 kishte vetëm 315,800 persona të regjistruar si të punësuar, me nja 152,000 të tjerë të paregjistruar por të punësuar, 95 përqind e këtyre të fundit në sektorin privat dhe gati dy të tretat meshkuj. Niveli i papunësisë është ritur mbi gatisë 130 përqind që nga viti 1991, duke arritur në 361,300. Sondazhet e vitit 1997 treguan që njerëzit ndjenin se situata e tyre është prishur qysh nga pavarësia. Që nga viti 1998 është llogaritur se rreth 25 për qind e atyre që jetojnë në regjionet rurale ishin në vobekësi, me të ardhura prej 2.5 \$ në ditë.²

Varfëria i preku të gjitha komunitetet, edhe pse i efektoi në mënyra të ndryshme. dhe u krijua një lidhje mes varfërisë dhe arsimimit të dobët. Si rrjedhim, femrat shqiptare në regjionet rurale, të cilat nuk kanë më shumë se shkollë fillore, ishin të goditura më ashpër. Pasiqë shumë pak shqiptarë ishin të punësuar në industrinë shtetërore, ata ishin shumë më pak të goditur me mbylljen e tyre. Megjithatë, për dallim nga shumica e maqedonasve, shqiptarët nuk mund të përfitonin nga privatizimi prej ndërmarrjeve të suksesshme shtetërore pasi që këto u shiteshin punëtorëve me çmim të ulët.

Për një kohë të gjatë komuniteti shqiptar ka qenë i varur nga dërgesat e atyre që kanë migruar në Gjermani në vitet e 60-ta dhe 70-ta. Shënimet jozyrtare kalkulojnë se Gjermania kishte rreth 150,000 punëtorë nga Maqedonia prej të cilëve rreth 120,000 ishin shqiptarë etnik.³ Dërgesat e tyre modeste mundësuan një injeksion të rëndësishëm të parave të gatshme në ekonominë lokale, duke e financuar zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM) në Maqedoni kah fundi i 1970-ve dhe 1980-ve. Sipas statistikave zyrtare në Maqedoni ka 12,800 biznese të vogla dhe ndërmarrje zanati, shumica e të cilave ishin të financuara nga këto puntorë migrant³. Këto të ardhura i kontribuan tërë komunitetit dhe sollen një shkallë të vetëmjaftueshmërisë, pavarësisht nga shteti. Sot dërgesat kanë rënë në 60 për qind, dhe shqiptarët etnik që kthehen në Maqedoni zakonisht i shtohen numrit të të papunësuarëve.³

Veprimtaritë bankare në Maqedoni

Janë të vogla mundësitë për shqiptarët që të huazojnë fonde për fillimin e një biznesi të vogël familjar. Shumica e bankave janë të dobëta në Maqedoni si shkak i nivelit të ulët të aktivitetit ekonomik dhe humbjes së madhe të fondeve që pasuan pas ndarjes nga Jugosllavia. Në vitin 1999 kishte 22 banka të licencuara legale. Ndërmarrjet e reja të pavarura e kanë shumë rëndë të tërheqin



Burra shqiptarë në kafene në Tetovë foto: Melanie Friend/Format Photographers

përkrahje prej bankave, dhe thëniet për korrupsionin e sistemit bankar rriten. Shumica e aksionerëve të bankave të privatizuara raportohet të kenë lidhje të ngushta me zyrtarët qeveritar, përderisa pakica e shqiptarëve në menaxhmentin e lartë mund të bëjë shumë pak në rritjen e besimit të disa shqiptarëve në banka.

Pesë bankat komerciale që operojnë në Maqedoninë Perëndimore rralë u japin kredi shqiptarëve. Për shembull, një studim i Agjensisë për Përkrahjen e Ndërmarrjeve (ESA) në Gostivar tregoi se në Maqedoninë Perëndimore vetëm 6 për qind e kredive bankare shkuan te shqiptarët.³

Puntorët migruer kthehen prej Gjermanie

Edhe pse Jugosllavia kishte një ekonomi të mirë, shqiptarët zakonisht ishin pak të punësuar dhe në shumicën e rasteve të papunësuar. Migracioni për punë në Gjermani ishte i formalizuar në marrveshjen bilaterale dhe i organizuar nga Zyra Shtetërore për Punësime në Maqedoni. Puna e tyre ishte e rëndësishme për ekonominë në rritje të Gjermanisë Perëndimore, përderisa dërgesat e tyre ishin të dobishme për ekonominë jugosllave, dhe kryciale për dalje nga varfëria për familjet që i lan pas tyre.

Megjithatë, me sfidat e reja të Gjermanisë së bashkuar, politikanët gjerman filluan të mërzhiten lidhur me numrin e azil kërkuesve dhe punëtorëve migruer, qeveritë gjermane dhe maqedonase më vitin 1996 lansuan një program për të mundësuar huazime për puntorët migruer që të kthehen në Maqedoni. U themelua një fond prej 20 milion DM, në të cilin qeveria gjermane participoi me 50 për qind. Ky fond duhej të mundësonte kredi për puntorët migruer në Gjermani që të kthehen në Maqedoni dhe të ngrejnjë e përkrahin NVM të posaformuara.

Shqiptarët dhe pakicat tjera e përkrahën fuqishëm këtë skemë. Shumica donin të kthehen në Maqedoni pas shumë viteve larg nga familjet e tyre. Më në fund dukej se ka ndonje prospekt për vetëpunësimin pa diskriminim institucional të ish-shtetit jugosllav, dhe vlera e promovimit të ndërmarrjeve të vogla ishte përfaqëuar nga shumë donatorë të rëndësishëm. U ngritën qendrat për konsultime të NVM ndërsa organizatat joqeveritare (OJQ) u financuan për të ndihmuar individë që aplikojnë për biznes grante. Nga Asociacioni

Gjerman për Investime (DEG) dhe Asociacioni Gjerman për Bashkëpunim Teknik (GTZ) u kërkua t'a implementojnë programin në partneritet me bankën maqedonase ALMAKO, dhe pastaj, pas kollapsit të kësaj, me Bankën Maqedone për Përkrahje të Zhvillimit.

Diskriminimi bankar

DEG themeloi zyrën në Shkup që të jetë si një urë mes bankës dhe njerëzve që do të kishin interes për kredi. Ata duhej të sjellin ekspertizë në vlerësimin e propozimeve dhe keshillimin e migrantëve kthyes që dëshironin të formojnë NVM.

Programi ishte i hapur për të gjithë qytetarët e Maqedonisë që ishin kthyer pas vitit 1991 ose që planifikonin të kthehen në ardhmëri. Aplikantët duhej që të kishin punuar legalisht në Gjermani mbi 2 vite dhe duhej të prezentojnë se ata: kanë ide konkrete për ndonjë aktivitet që ata do të zhvillonin, do të kishin kualifikim profesional dhe komercial, dhe do të punonin ekskluzivisht në ndërmarrjen që do t'a zhvillonin.

Përkrah mundësimin të haurimeve për themelimin e NVM-ve të reja, programi mund t'i jepte kredi ndërmarrjeve të formuara në tri vitet paraprake. Kredi mundej të blenin kompanitë ekzistuese ose të investojnë në partneritet.

Shumica e shqiptarëve shpresonin të kthehen në vendlindje dhe të krijojnë biznese të vogla familjare. Ata shpresonin se këto do t'i punësonin vetë ata dhe një ose dy anëtarë të familjes – në bujqësi, ndërtimtari, prodhimtari, ose shërbime tjera – me qëllim të vetëm të sjellin dinjitetin, të ardhurat dhe unitetin në familjet e tyre. Programi, si duket, u shfaq sensitiv në kuptimin e kulturës, meqë shumica e meshkujve shqiptarë, dhe një numër më i vogël i femrave, do t'iu mundësohej të udhëheqin bizneset e tyre.

Programi filloi shumë ngadalë, në qershor të vitit 1996, dhe në dy vitet e para nuk u bë asnjë kreditim por iu ofruan trajnime të biznesit nje grupi të madhe të personave në Maqedoni. Qëllimi ishte që këto persona të inkurajohen që të aplikojnë për kredi. Megjithatë, mes shqiptarëve kishte shqetsime se aplikacionet e tyre hasin në vonesa nga ana e aplikantëve pohohej sa ta duhej të jepnin "stimulime" për t'a përshpejtuar procesin të oficerët e kredive.³ Më tutje, hulumtimet e DEG tregojnë se kishte vetëm 68 aplikantë për kredi, 45 % prej maqedonasve, 25 % prej shqiptarëve dhe

Shfrytëzuesit e kredive sipas përkatësisë etnike:

Shfrytëzuesit e kredive sipas përkatësisë etnike	Përqindja e fituesve të kredive sipas përkatësisë etnike	Fonde personale në DM	Kredi nga Ministria për zhvillim në DM	Kredi nga ALMAKO Banka në DM	Sasia totale e shfrytëzuesve në DM
Maqedonas	89%	1,063,272,800	1,063,272,800	1,063,272,800	7,298,860
Shqipëtarë	9%	147,567,300	147,567,300	147,567,300	647,834
M. muslimanë	2%	2,7000,00	2,7000,00	2,7000,00	20,000
Turqë	0%	0	0	0	0
Tjerë	0%	0	0	0	0
Total	100%	1,213,540,100	1,213,540,100	1,213,540,100	7,966,694

(në fazën e dytë të programit, u dhanë 14 kredi: 12 maqedonasve, 1 shqiptari dhe 1 turku)

34 % prej grupeve tjera etnike. Kjo ishte befasi pasi që shumica e puntorëve migrues prej Maqedonie ishin shqiptarë.

Prej vitit 1997 deri më 2001 kreditë ishin të shpërndara si në tabelën më poshtë.³ Nuk ka dëshmi që tregojnë se shqiptarët kanë më pak nevojë për kredi, ose më pak aftësi të konstruktive në një biznes plan. Vijimisht, madje edhe planet e përpiluara për shqiptarët nga agjenci të specializuara siç është Agjencia për Përkrahje të Ndërmarrjeve, ishin të refuzuara nga bankat komerciale.³ Si rrjedhim, është e rëndësishme të shqyrtohen faktorët tjerë. Disa nga shqetësimet e shqiptarëve janë se:

- E vetmja zyrë e DEG-ut është në Shkup (përderisa shumica e shqiptarëve janë në Maqedoninë Perëndimore)
- Shqiptarët ose pjesëtarët e pakicave tjera kanë qenë të nënperfaqësuar mes stafit të programit. DEG-u angazhoi 21 konsultantë të përkohshëm për përgaditjen e projektit, prej të cilëve vetëm dy ishin shqiptarë kurse prej pakicave tjera nuk kishte asnjë. Zyra e DEG-ut në Shkup angazhoi nëntë konsultantë lokal për të tërhequr klientë të ri dhe të gjithë ata ishin prej Shkupi.
- Nuk kishte asnjë material promotiv ose ndonjë transmetim në ndonjë gjuhë jomaqedonase.
- Biznes trajnimi dy vjeçar dështoi në përfshirjen efektive të të kthyerëve nga Gjermania.

Shumica e shqiptarëve që kishin shpresuar të përfitojnë prej këtij programi, erdhën në shtëpi por së shpejti u kthyen në Gjermani të dëshpëruar. Ata ndjejtën se programi ishte shpresë e rrejshme, dhe se familjet e tyre do të mbeteshin në varfëri nëse i lëshonin punët e tyre në Gjermani për t'u bërë të papunuar në shtëpi.

Ardhmëria

Programi për mundësimin e kredive për kthimin e punëtorëve migrant prej Gjermanie në Maqedoni u krijua në besim të mirë nga ana e qeverisë gjermane dhe në masë të madhe u prit mirë nga shqiptarët. Por shumica e shqiptarëve mendojnë se programi dështoi. Ka shumë shqiptarë që janë në Gjermani dhe duan të kthehen, pasi që fonde të limituara që janë shpenzuar kanë arritur shumë pak tek

punojmë në sigurimin e të drejtave të pakicave dhe vendasve

minority
rights
group
international

shqiptarët. Si duket programi e ka humbur drejtimin e vet. Mungesa e participimit efektiv të shqiptarëve duhet të jetë dëshpërim për të gjithë, duke i përfshirë edhe përpiluesit e programit.

Në të ardhmen duhet inkurajuar një qasje e re. Programet e ndihmës duhet të jenë transparente në të gjitha nivelet, dhe të kenë pjesëmarrjen e plotë e të gjitha komuniteteve të përfshira. Programet e tilla duhet të jenë konsistente me Deklaratën mbi Minoritetet e Kombeve të Bashkuara, Konventën Kornizë të Këshillit të Europës për Mbrojtjen e Pakicave Nacionale dhe Konventën Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor.

Shënime

1 Shiko statistikën në websajtin e IMF dhe World Bank (Bankës Botërore)

2 Ibid

3 Agjencia për Përkrahjen e Ndërmarrjeve (ESA), Gostivar, Maqedoni

4 Te dhënat zyrtare për bizneset gjatë vitit 1993 deri 2000, të mundësuar nga zyra shtetërore statistikore në Shkup, Maqedoni

5 ESA

6 Ibid

7 Klientët e ESA-s janë ankuar rregullisht për këtë

8 Asociacion Gjerman për të dhëna rreth Investimeve

9 Ibid

10 Shumica e klientëve janë refuzuar pa sqarime

Rekomendimet

1. Donatorët ndërkombëtarë duhet t'a rishqyrtojnë substancën dhe implementimin e programeve ndihmë në Maqedoni që të sigurojnë që ata të jenë inkluziv për pakicat. Komunitetet pakicë do të duhej të jenë plotësisht të përfshira në planifikimin dhe implementimin e programeve ndihmë.
2. Donatorët ndërkombëtarë do të duhej t'a hulumtojnë ndikimin e diskriminimit në arritjen e objektivave të programeve ndihmë, ndërsa duhet të adoptohen edhe përgjigjet e përshatshme për t'a kaluar ndikimin e diskriminimit. Këto strategji do të duhej të elaborohen në bashkëpunim me pakicat.
3. Qeveria gjemane duhet t'i rishqyrtojë dhe monitorojë programet e saja mikro – kredituese për të mundësuar kredi për puntorët migrues kthyes, të sigurojë se programet i plotësojnë objektivat dhe i përfshijnë shqiptarët dhe pakicat tjera në mes përfituesve të tyre.

Te drejtat e pakicave dhe zhvillimi është një program hulumtues dhe advokativ, i themeluar nga MRG dhe partnerët e saj, për t'iu adresuar përjashtimit në lidhje me zhvillimin dhe marginalizimin e pakicave dhe komuniteteve vendase, dhe të punojë kah eliminimi i varfërisë.

Falemenderim MRG dhe program partnerët me falemenderim e pranojnë dhe njohin përkrahjen e Christian Aid, DFID, Qeverinë norvegjeze dhe Staples Trust. Autorët janë Albert Musliu, Drejtor Ekzekutiv i ADI, me Visar Ademin, konsultatnt, Koordinator i Projektit: Angela Haynes; Editor: Katrina Payne. *Mikro – kredit*, Varfëria dhe kthimi i pakicave etnike © Minority Rights Group International, UK dhe Asociacioni për Iniciativa Demokratike, Maqedoni, Dhjetor 2002. Ky studim është publikuar si kontribut në kuptimin e publikut më të gjërë, dhe është pjesë e programit Të drejtat e pakicave dhe zhvillimi. Teksti jo patjetër i paraqet në detaje pikpamjet e MRG dhe partnerëve të saj. Kopje të këtij mikro – studimi mund të gjeni në www.minorityrights.org. Kopje poashtu mund të sigurohen në zyrën e MRG në Londër. Ky studim do të mundësohet edhe në gjuhën shqipe dhe maqedonase prej ADI-t.

Grupacioni Ndërkombëtar për të Drejtat e Pakicave (MRG) është organizatë joqeveritare që punon të mundësojë të drejtat e pakicave etnike, religjioze dhe gjuhësore dhe popujve vendas të mbarë botës, dhe të promovojë bashkëpunimin dhe mirkuptimin ndërmjet komuniteteve. Aktivitetet tona janë të fokusuar në mbrojtjen ndërkombëtare, trajnim, publikime dhe tejkallimin e kufijve. Në prihemi nga nevojat e shprehura nga rrjeti partner ndërkombëtar i organizatave që paraqesin pakicë dhe popujt vendas. MRG ka status konsultativ me Këshillin Ekonomik dhe Social të Kombeve të Bashkuara (ECOSOC). MRG është e regjistruar si shoqatë bëmirese, numër 282305, dhe kompani aksionare me garanta në UK numer 1544957.

Asociacioni për Iniciativa Demokratike (ADI) është themeluar në Gostivar, Maqedoni me 1994. ADI është organizatë multietnike e përkushtuar në ndërtimin e shoqërisë qytetare në Maqedoni. ADI është regjistruar legalisht në Republikën e Maqedonisë dhe është përcaktuar si OJQ e autorizuar të drejtojë iniciativë qytetare.

Asociacioni për Iniciativa Demokratike, Maqedoni
B. Jovanovski 61, 1230 Gostivar
Tel +389 42 22 11 00
Faks +389 42 22 11 02
e-mail adi@adi.org.mk
URL <http://www.adi.org.mk/>

Minority Rights Group International 379
Brixton Road, London sw9 7DE, UK
Tel +44 20 797809498
Fax +44 20 773806265
e-mail minority.rights@mrgmail.org
URL <http://www.minorityrights.org/>